

Kodi

për një proces zgjedhor korrekt dhe demokratik

Duke u nisur nga një përkushtim i përbashkët për zgjedhje demokratike dhe korrekte;

Të vetëdijshëm se legjislacioni zgjedhor, tashmë gati një dekadë, nuk është reformuar apo përshtatur me nevojat dhe kërkesat e reja të procesit zgjedhor dhe se ka mangësi në raport me nivelin e dëshiruar të cilësisë së procesit zgjedhor;

Të përkushtuar ndaj ruajtjes së integritetit të zgjedhjeve dhe ndërtimit të besimit të qytetareve dhe qytetarëve të Malit të Zi në procesin zgjedhor;

Të bindur se zgjedhjet demokratike janë baza e legjitimitetit e të gjitha institucioneve dhe politikave dhe garancia e një qeverisjeje të qëndrueshme dhe të mirë që mund t'i zbatojë reformat e nevojshme dhe ta sjellë vendin më pranë anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

Listat zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet parlamentare të vitit 2023 kanë ra dakord të nënshkruajnë Kodeksin për një proces zgjedhor korrekt dhe demokratik (më tutje në tekst: Kodeks) me Qendrën për Tranzicionin Demokratik (CDT), një organizatë joqeveritare që është e angazhuar në vëzhgimin qytetar të proceseve zgjedhore që nga viti 2000

Listat zgjedhore, nënshkrueset e Kodeksit, kanë pranuar të respektojnë këtë sistem rregullash dhe parimesh gjatë fushatës zgjedhore, ditën e zgjedhjeve dhe në periudhën pas-zgjedhore gjatë zgjedhjeve parlamentare që do të mbahen më datë 11 qershor 2023 dhe marrin përsipër publikisht që të sigurojnë që rregullat e përfshira në të të promovohen publikisht, t'u prezantohen zyrtarëve/eve, anëtarëve/eve dhe aktivistëve/eve të partive dhe të respektohen nga të gjithë.

Kodi

për një proces zgjedhor korrekt dhe demokratik

I Respektimi i Kodit

Listat zgjedhore, nënshkrueset e këtij Kodeksi detyrohen që të:

- ndërmarrin hapa vendimtarë për të ndaluar zyrtarët/et, kandidatët/et dhe anëtarët/et që të shkelin dispozitat e tij dhe pa përjashtime të respektojnë dispozitat e këtij Kodeksi;
- bëjnë gjithçka në fuqinë e tyre për t'i bindur simpatizantët/et e tyre nga shkelja e dispozitave të tij;
- të përmbahen nga paraqitja e ankesave të pavërteta, joserioze ose keqdashëse që pretendojnë shkeljen e tij.



II Respektimi i ligjit

Listat zgjedhore nënshkrueset e këtij Kodeksi janë të detyruara të respektojnë ligjet, rregullat dhe procedurat e vlefshme zgjedhore.



III Zbatimi i fushatës

Listat zgjedhore nënshkruhet e këtij Kodeksi detyrohen për:

- respektimin e të drejtës dhe lirisë së të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje për të bërë fushatë dhe përhapur idetë dhe parimet e tyre politike;
- sjellje që respekton të drejtat e listave, si dhe të drejtat e të gjithë votuesve/eve dhe anëtarëve/eve të tjerë të komunitetit;
- respektimin e lirisë së votuesve/eve për të marrë pjesë në aktivitete politike;
- respektimin e së drejtës së privatësisë së qytetarëve/eve;
- respektimin e së vërtetës dhe të drejtave të publikut, informimin objektiv dhe angazhimin për kontrollin e fakteve;
- kundërshtimin e ndikimeve të paligjshme dhe të papërshtatshme politike, financiare, mediatike apo të çdo ndikimi tjetër të huaj në procesin zgjedhor, pavarësisht se nga vijnë ato;
- kundërshtimin fushatave dezinformuese që synojnë nënvlerësimin e procesit zgjedhor demokratik.

Listat zgjedhore, nënshkruhet e këtij Kodeksi nuk do të:

- parandalojnë ose pengojnë gazetarët të kryejnë punën e tyre në përputhje me rregullat e profesionit të gazetarisë dhe standardet zgjedhore;
- parandalojnë ose ndërhyjnë në tubime publike ose aktivitete propagandistike të partive të tjera;
- shkatërrojnë materialet propagandistike të pjesëmarrësve të tjerë në zgjedhje;
- kryejnë fushata anonime negative kundër kundërshtarëve politikë;
- publikojnë ose shpërndajnë në ndonjë mënyrë tjetër informacionet burimin e të cilave nuk e dinë ose nuk mund ta verifikojnë;
- përdorin fushata në rrjetet sociale për të promovuar dhunën dhe/ose për të frikësuar votuesit;
- përdorin qasjen në mediat e huaja për të anashkaluar rregulloret kombëtare dhe për të fituar një avantazh të padrejtë mediatik

Listat zgjedhore, nënshkruhet e këtij Kodeksi në mesazhet e tyre publike nuk do të:

- përdorin fyerje dhe nuk do të ngrijnë tensione të pajustificueshme gjatë procesit zgjedhor;
- paraqesin informacione që nuk mbështeten me prova të sakta, me qëllim të diskreditimit dhe përçmimit të listave dhe kandidatëve të tjerë zgjedhorë;
- bëjnë kërcënime ose thirrje për dhunë ndaj çdo personi ose grupi;
- tregojnë çfarëdo lloji jo tolerancës ose urrejtjes ndaj anëtarëve të kombeve ose konfesioneve të tjera, ose grupeve të pakicave.



IV Procedura zgjedhore

Listat zgjedhore nënshkrueset e këtij Kodeksi janë të detyruara që:

- mos të ushtrojnë çfarëdo presioni politik mbi anëtarët/et e administratës zgjedhore dhe/ose të drejtojnë marrjen de vendimeve që janë në interes të veçantë politik;
- të bashkëpunojnë profesionalisht me autoritetet për realizimin e zgjedhjeve, me qëllim të zbatimit paqësor dhe ligjor të procedurës zgjedhore dhe mundësimit të votuesve/eve që të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës pa ngacmime dhe ndërhyrje;
- që kontribuojnë për mbarëvajtjen e zgjedhjeve në vendvotim;
- të respektojnë pavarësinë dhe të bashkëpunojnë me vëzhguesit e autorizuar të zgjedhjeve;

Nënshkrueset e këtij Kodeksi nuk do të:

- ndikojnë në rezultatin e votimit me aktivitete të dhunshme ose të paligjshme;
- ndërhyjnë në mënyrë të pajustificueshme ose me qëllim të keq në punën e anëtarëve të administratës zgjedhore, në procesin e votimit, në numërimin e votave ose në përcaktimin e rezultateve përfundimtare;
- rrezikojnë me aktivitetet e tyre sigurinë e anëtarëve/eve të administratës zgjedhore para, gjatë dhe pas zgjedhjeve;
- ndikojnë në vendimin e votuesve/eve në vendvotim, ose në afërsi të vendvotimit;
- ndërhyjnë në mënyrë të pajustificueshme ose keqdashëse në punët e anëtarëve/eve të organit për zbatimin e zgjedhjeve;
- ndikojnë tek votuesit që të votojnë më shumë se një herë, ose të votojnë në emër të një personi tjetër, të gjallë, të vdekur ose që nuk ekziston;
- dërgojnë votuesve/eve të tyre informacione të rrema për të drejtat dhe detyrimet e tyre në procesin zgjedhor dhe procedurat zgjedhore;



V Promovimi i jo dhunës

Listat zgjedhore, nënshkrueset e kësaj Marrëveshjeje, bien dakord që dhuna në çfarëdo forme është e papranueshme dhe marrin përsipër që të:

- shprehin një ndalim të qartë për zyrtarët/et, kandidatët/et, anëtarët/et dhe aktivistët/et e tyre për të ushtruar dhunë ndaj kujtdo;
- dënojnë publikisht dhunën ose kërcënimet, ose çdo akt vandalizmi ose prishjeje të rendit publik nga zyrtarët/et, kandidatët/et, anëtarët/et ose simpatizuesit/et e tyre;
- japin udhëzime zyrtarëve/eve, kandidatëve/eve, anëtarëve/eve dhe aktivistëve/eve të tyre duke ndaluar qartë mbajtjen e armëve të ftohta ose të zjarrit gjatë fushatës zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve.

Nënshkruessit e këtij Kodeksi nuk do të:

- marrin pjesë ose kryejnë ndonjë akt dhune për të demonstruar forcën ose mbizotërimin e partisë;
- shkaktojnë dëmim të pronës private ose publike të listave të tjera zgjedhore;



VI Parandalimi i abuzimeve

Listat zgjedhore, nënshkruese të këtij Kodeksi, janë të përkushtuara kundër abuzimeve me burimet publike në fushatën zgjedhore.

Nënshkrueset e këtij Kodeksi nuk do të:

- abuzojnë pozitën, privilegjin ose ndikimin për qëllime politike, duke ofruar shpërblime, kërcënime me ndëshkim ose në ndonjë mënyrë tjetër;
- përdorin pronën shtetërore, komunale ose prona të tjera publike për qëllime të fushatës;
- përdorin punësimin në administratën dhe ndërmarrjet publike si mjet për të arritur përparësi institucionale ndaj pjesëmarrësve të tjerë në zgjedhje;
- ushtrojnë ndikim politik në organet shtetërore dhe komunale për të favorizuar qëllimet e tyre politike gjatë fushatës zgjedhore;
- abuzojnë me funksionet publike për të fituar një avantazh të padrejtë në qasjen në media.

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje zotohen të mos:

- ushtrojnë presion, ndikim financiar ose ndikim tjetër të paligjshëm ndaj qytetarëve/eve për të votuar për ose kundër një partie të caktuar, ose për të abstenuar nga votimi;
- ushtrojnë presion, ndikim financiar ose ndikim tjetër mbi qytetarët për të qenë ose jo kandidatë/e në listën zgjedhore, për të tërhequr ose jo kandidaturat e tyre;
- keqpërdorin statusin ekonomik, social apo shëndetësor të dikujt, me qëllim që të ndikojë në vullnetin e lirë të votuesve/eve.



VII Pranimi dhe respektimi i vullnetit të shprehur në mënyrë demokratike të qytetarëve/eve

Listat zgjedhore të nënshkrueseve të këtij Kodi bien dakord që një nga postulatet themelore demokratike është respektimi i vullnetit lirisht të shprehur të qytetarëve/eve.

Nënshkrueset marrin përsipër që të:

- pranojnë rezultatin e zgjedhjeve, që konfirmohet në procesin ligjor të zgjedhjeve;

- sillen me përgjegjësi ndaj procesit të përcaktimit të rezultateve zgjedhore dhe që nuk do të pengojnë procesin zgjedhor duke paraqitur ankesa të pabazuara;
- pranojnë dhe respektojnë vendimet përfundimtare të organeve kompetente shtetërore;
- përmbahen nga organizimi i festimeve para shpalljes së rezultateve të besueshme të zgjedhjeve.



VIII Realizimi i Kodit

QTD/CDT merr përsipër të formojë një ekip (Ekip) multidisiplinar, të përbërë nga ekspertët/et e fushave të caktuara të procesit zgjedhor dhe një rrjet koordinatorësh rajonalë dhe komunalë, që, në bashkëpunim me nënshkrueset, do të analizojnë çdo denoncim individual dhe do të përgjigjen në mënyrë të përshtatshme dhe do të monitorojnë realizimin e këtij Kodeksi deri në përfundimin e procesit zgjedhor.

Ekipi do të komunikojë drejtpërsëdrejti me të gjitha nënshkrueset e marrëveshjes që kanë kundërshtime në lidhje me shkeljen e këtij Kodeksi, por edhe me autoritetet shtetërore që mund të kenë juridiksion lidhur me objektin e kundërshtimit.

Në punën e Ekipit mund të përfshihen edhe përfaqësuesit/et e vëzhguesve ndërkombëtarë të zgjedhjeve.

Puna e Ekipit bazohet në parimet e transparencës, mirëbesimit dhe besimit reciprok me listat zgjedhore të Kodeksit.

Listat zgjedhore, nënshkrueset, do të caktojnë ka një përfaqësues që do të jetë në dispozicion të Ekipit për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë Kodeks.

QTD/CDT, bazuar në përfundimet e Grupit për ankesa individuale, informon publikun për rezultatin e procesit dhe/ose informon autoritetet kompetente shtetërore në rast të dyshimeve për shkelje të ligjit.



IX Zbatimi i Kodit

Të gjitha listat zgjedhore të konfirmuara që, për çfarëdo arsyeje, nuk kanë marrë pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të këtij Kodeksi, mund të detyrohen ta respektojnë atë, duke shprehur publikisht pranimin e përmbajtjes së tij.

Zbatimi i këtij Kodeksi fillon me ditën e nënshkrimit dhe përfundon me përcaktimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Në Podgoricë

25.5.2023.

Albanska alijansa

Albanski forum – Nik Gjelošhaj „BESA Za Evropski Razvoj“

ALEKSA I DRITAN – HRABRO se broji!

EVROPA SAD! – MILOJKO SPAJIĆ

HGI – Na pravoj strani svijeta!

Jasno je! Bošnjačka stranka - mr Ervin Ibrahimović

DA, MI MOŽEMO ZA GRAĐANSKU CRNU GORU!

NARODNA KOALICIJA – „SLOŽNO I TAČKA“ – (Dejan Vukšić – Demohrišćanski pokret, Marko Milačić – Prava Crna Gora, Vladislav Dajković – Slobodna Crna Gora, Dragica Perović – Demokratska srpska stranka, dr Novica Stanić – Pokret za Pljevlja)

PRAVDA ZA SVE! – dr Vladimir Leposavić

Pokret za promjene - PRVO CRNA GORA – Nebojša Medojević – Reforme za spas zemlje

Preokret za sigurnu Crnu Goru – Srđan Perić

SDP – ZA NAŠU KUĆU

SNP – DEMOS – ZA TEBE

ZAJEDNO! Za budućnost koja ti pripada – Danijel Živković (DPS, SD, DUA, LP)

ZA BUDUĆNOST CRNE GORE (Nova srpska demokratija, Demokratska narodna partija Crne Gore, Radnička partija)

Centar za demokratsku tranziciju (CDT)

